



REPUBLIC OF KOSOVO ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DMP	Nr. Prot. 03-3774/12
Dep. 02	Prot. No. 19-10-2012
Nr. Ifaq.	Emri
Broj. stranca	Datimi
Nr. pages	Dati



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË VUSHTRRI/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U VUČITRNU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN VUSHTRRI

Nr. 7790 /12

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE VUSHTRRI, gjyqtari duke vendosur ne proceduren kundervajttese kunder te pandehurit Zeqir Hasani nga Vushtrria per kundervajtje nga neni 17,paragrafi 1 pika 1 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte publik e ne baze te nenit 73. 195 dhe 199 te LMK-es, me dt.04.10. /12 viti, bjen kete:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Zeqir Xhevat Hasani i lindur me dt.15.01.1972 ne fsh. Ceceli Komuna e Vushtrris kurse tani jeton ne Vushtrri rruga Bahri Kuqi p.nr. i martuar babai i dy femije, me shtetesi Kosovar, te kryer fakultetin, gjendja ekonomike e mire deri me tani jo i denuar per kundervajtje e as per nen hetime jo i denuar.

ESHTE FAJTOR

SEPSE: Zyrtari publik Zeqir Hasani nga Vushtrria nuk e ka permbushur obligimin ligjor qe parasheh Ligji nr. 04/L-050 per deklarimin prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise se zyrtareve publik ne afatin ligjor prej nje maresi deri 31 mars i cili afat eshte ligjor per deklarimin e rregullt vjetor te pasurise te zyrtareve te larte publik.

Me kete ka bere kundervajtje nga neni 17 paragrafi 1 pika 1 te Ligjit per deklarimin, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurise te zyrtareve te larte publik dhe per kete:

D E N O H E T

ME DENIM NE TE HOLLA NE SHUME PREJ 1000 euro i pandehuri eshte i obliguar qe ne afatin prej 15 dite pas plotefuqishmeris se ketij aktvendimi e nese te njejten nuk e paguan e njejta do t'i zevendesohet me denim **BURGU** ne kohezgjatje prej 30 ditesh duke llogaritur cdo dite vuajtje te burgut 15 euro.

Obligohet i pandehuri qe ne emer te paushallit gjyqesor te paguaje shume prej 5 euro ne te njejtin afat ligjore.

Nga nje kopje te aktvendimit te dergohet paleve



A r s y e t i m

AGJENCIA KUNDER KORUPCIONIT ne Prishtine me kerkesen e vet nr.01-2543/12 te dt.24.07 /12 viti, ka kerkuar te zhvillohet procedura kundervajtese kunder te pandehurit.

I pandehuri eshte mare ne pyetje prane kesaj gjykate dhe ne mbrojtjen e vet shton: E vertet eshte se per vitin kalendarik 2011 nuk e kam deklaruar pasurin – prejardhjen per arsye se kam qene i dhene pas disa puneve te tjera meqe babain e kam pas te smuar dhe kete pune e kam qit ne hares dhe jam i gaqshem te i pergjigjem gjykates per leshimin e leshuar.

Gjyqtari duke i vleresuar shkresat e lendes dhe nga vet deklarata e te pandehurit konstatoi se i pandehuri eshte pergjegjes per kundervajtje qe i vihet ne bare per te njehtin e shpalli fajtor dhe e denoj si ne dispozitiv te ketij aktvendimi me bindje se edhe me kete lloje denimi do te arrihet qellimi i duhur ndaj te njehtit ne ate menyre qe ne te ardhmen mos ta perseris nje kundervajtje te tille nga se ne te kunderten do te pasoje masa shume me te ashpera ligjore ndaj te njehtit.

Nga se u cek me larte u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

GJYKATA KOMUNALE PER KUNDERVAJTJE NE VUSHTERRI, me .dt.04.10./12 viti.


GJYQTARI
 Kamer Cakaj

KESHILLA JURIDIKE: Kunder ketij aktvendimi i pandehuri dhe fleteushtuesi mund te ushtrojne ankes ne Gjykatën e Larte per Kundervajtje ne Prishtine ne afatin prej 8 dite pas marrjes se te njehtit. Ankesa dergohet permes kesaj gjykate pa pulla.